



ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (ZPS) KËRKON QË THAÇIT, VESELIT DHE SELIMIT
T'U PEZULLOHEN VIZITAT DHE TË GJITHA KOMUNIKIMET

FAQE 4-5

MUSLIU: SPECIALJA, NË MUNGESË TË PROVAVE DHE FAKTEVE, PO PËRDOR METODA TË FRIKSHME



Phil ngjaj (ZPS-472)

Zyra e Prokurorit të Specializuar ka kërkuar të enjten që Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit t'u pezullohen vizitat dhe të gjitha komunikimet, përveç me ekipin e avokatëve. Sipas ZPS-së, ata kanë shkelur urdhrat e trupit gjykues duke zbuluar identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur dhe/ose

shpërndarjen e përmbytjes së dëshmisë konfidenciale për personat që i vizitojnë në Qendrën e Paraburgimit. Ndaj këtij lajmi ka pasur reagime të shumta në Prishtinë. KMDLNj ka theksuar se Specialja po vazhdon shkeljet ndaj të paraburgosurve, duke mos u pajtuar edhe me

heshtjen e institucioneve të Kosovës që janë vënë në krah të kësaj gjykate. Ndërkaq deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, ka kërkuar reagim të Kuvendit të Kosovës, duke theksuar se Specialja është duke përdorur metoda të frikshme të shkeljes të të drejtave të njeriut

OPINION

HIMARA DHE MIRËDITA PËRBALLË HELENIZIMIT DHE ARABIZIMIT! F. 9

Dr. Simon PUTA /
Kirurg dhe ish-
deputet i Parlamentit
të Shqipërisë



AKTUALE

KATARI THOTË SE ARMËPUSHIMI NË GAZË NIS TË PREMTEN F. 2

HARADINAJ BËN THIRRJE QË KUVENDI TË HARTOJË REZOLUTË PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË NATO F. 3

LIGJ I RI PËR ZGJEDHJET, KOZ-ja DO TË ZHVILLOJË TAKIME ME KRYETARËT E KOMUNAVE F. 5

EKONOMI



MBAHET TRAJNIMI PËR BIZNESET E SEKTORIT TË BUJQËSISË F. 8

MURATI THOTË SE VITIN E ARDHSHËM KOMUNAT DO TË KENË MBËSHETJET REKORD ME BUXHET F. 8

SPORT



BATATINA VETËKANDIDOHET PËR TRAJNER TË KOSOVËS, OPSION EDHE DAJA E DE BIASI F. 10

MIRATOHEN DISA MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE, PDK-JA S'MERR PJESË NË VOTIM

FAQE 7



FLAKA NË INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE ZHUKI MBETJET E ADEM JASHARIT DHE TË ISA BOLETINIT

FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shefi i logjistikës së NATO-s: Po na mbaron koha

BRUKSEL, 23 NËNTOR - NATO ka paralajmëruar anëtarët e saj se shumë burokraci po pengojnë lëvizjet e trupave në të gjithë Evropën, një problem që mund të shkaktojë vonesa të mëdha nëse do të shpërthejë një konflikt me Rusinë. “Po na mbaron koha. Atë që nuk e bëjmë në kohë paqeje nuk do të jetë gati në rast krize ose lufte”, tha shefi i komandës logjistike të NATO-s, gjenerallejtënant Alexander Sollfrank, në një deklaratë për “Reuters”.

Komanda e Përbashkët Mbështetëse dhe Mundësuese e NATO-s (JSEC) filloi të operojë në Ulm të Gjermanisë në vitin 2021. JSEC ka për detyrë ta koordinojë lëvizjen e shpejtë të trupave dhe tankeve në të gjithë kontinentin dhe përgatitjet logjistike si ruajtja e municioneve në aleancën krahu lindor.

Si rezultat i pushtimit të Ukrainës nga Moska në vitin 2014, krijimi i JSEC pasqyroi vlerësimin se NATO,

pas dekadave nga Lufta e Ftohtë, përsëri duhej të ishte gati për një luftë në Evropë që mund të shpërthejë në çdo kohë. Megjithatë, detyra e vendosjes së shpejtë të forcave deri në madhësinë e një divizioni me rreth 20 000 trupa, si dhe për të pasur municion, karburant, pjesë këmbimi dhe furnizime, është bërë më e ndërlikuar që nga Lufta e Ftohtë.

Ndërkaq trupat e NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës në të kaluarën u përballën me njëra-tjetrën kryesisht në Gjermani, aleanca është zgjeruar që atëherë rreth 1 000 kilometra në lindje, duke shumëzuar gjatësinë e krahut lindor të NATO-s në rreth 4 000 kilometra në total. “Zgjerimi i hapësirës, fakti që jo të gjitha forcat janë të bazuara në përpara - e gjithë kjo do të thotë se aleanca duhet të jetë e shpejtë në lëvizjen e trupave nga bazat e tyre në vendin e duhur në krahun lindor”, theksoi Sollfrank. “Në kulmin e luftës në

Ukrainë, Rusia gjuante 50 000 predha artilerie në ditë. Këto raunde duhet të arrijnë deri tek obusët”, tha ai. “Kështu që ju duhet të vendosni magazina - për municione, karburant, pjesë këmbimi dhe furnizime”.

Ashtu siç është, forcat e NATO-s duhet të navigojnë një sërë rregulloresh kombëtare, nga njoftimi paraprak i kërkuar përpara se municionet të mund të dërgohen deri në gjatësinë e lejuar të kolonave ushtarake.

“Ne kemi një tepërcë rregullash, por e vetmja gjë që nuk kemi është koha”, paralajmëroi admiral Rob Bauer, kreu i komitetit ushtarak të NATO-s. “Lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka dëshmuar të jetë një luftë rrërimi - dhe një luftë rrërimi është një betejë logjistike”.

Sollfrank tha se do të dëshironte të shihte një “Schengen ushtarak”, një zonë me kalim të lirë ushtarak të ngjashëm me zonën politike Shengen që lejon lëvizjen e lirë brenda pjesës më të madhe të BE-



së. NATO nuk duhet të shkaktojë një llogaritje të gabuar në Kremlin duke dhënë përshtypjen se Moska mund të ketë një shans për të fituar sepse aleanca nuk është e përgatitur, paralajmëroi ai. “Ne

duhet të jemi përpara kurbës. Ne duhet ta përgatitim teatrin shumë përpara se të thirret neni 5”, tha ai, duke iu referuar klauzolës së mbrojtjes kolektive të NATO-s, e cila efektivisht e vë aleancën në luftë.

Pavarësisht prej mospajtimeve me Orbanin, KE-ja miraton fondet për Hungarinë

BUDAPEST, 23 NËNTOR - Komisioni Evropian ka miratuar fondet për Hungarinë në vlerë prej 900 milionë eurosh, pavarësisht prej përpjekjeve të kryeministrit hungarez për ta bllokuar ndihmën që BE-ja dëshiron t'i japë Ukrainës.

Këto para vijnë nga programi REPowerEU i BE-së, që synon t'i ndihmojë 27 shtetet e BE-së që të rimëkëmben nga kriza e energjisë, që u shkaktua nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës vitin e kaluar. Ky program, po ashtu, synon ta ulë varësinë nga karburantet fosile ruse.

Vendimi për zhbllokimin e fondeve vjen përderisa kryeministri hungarez Viktor Orban - një kritik i BE-së që shpesh grindet me liderët e BE-së



lidhur me nivelin e sundimit të ligjit në shtetin e tij - ka kërcënuar se do t'i pengojë ambiciet e

Ukrainës që të anëtarësohet në bllok dhe planet e BE-së për t'i dhënë ndihmë Kievit në vlerë prej

50 miliardë eurosh. Liderët e BE-së do të takohen në Bruksel muajin e ardhshëm për të diskutuar për nisjen formale të bisedimeve për anëtarësimin e Ukrainës.

Shtetet e BE-së kanë katër javë kohë për ta mbështetur vendimin e Komisionit Evropian dhe për ta miratuar dhënien e fondeve për Hungarinë.

Vlera totale e planit për rimëkëmbjen pas pandemisë së Hungarisë, që përfshin edhe programin REPowerEU, arrin në 10.4 miliardë euro në hua dhe grante. Komisioni ka insistuar që Hungaria duhet të arrijë reforma në sundim të ligjit në mënyrë që fondet të zhblllokohen.

Hungaria, që pranon fonde të shumta nga BE-ja, është përballur

me kritika të shumta për shkak të nivelit të demokracisë. KE-ja për pothuajse një dekadë ka akuzuar Orbanin se ka shkatërruar institucionet demokratike, ka marrë nën kontroll mediet dhe ka kufizuar liritë e minoriteteve. Orban, që gjendet në pushtet që nga viti 2010, mohon akuzat.

Orbani i ka kritikuar sanksionet e vendosura ndaj Rusisë për shkak të luftës ndaj Ukrainës, pasi i ka cilësuar joproduktive dhe muajin e kaluar është takuar me presidentin rus Vladimir Putin. Kjo ishte hera e parë që Putini u takua me një lider të një shteti të BE-së që nga nisja e luftës.

Dhjetorin e kaluar BE-ja ngriu miliarda euro në fonde për Hungarinë për shkak të dështimit të reformave në sundimin e ligjit.

Katari thotë se armëpushimi në Gazë nis të premten

DOHA, 23 NËNTOR - Katari tha se armëpushimi në luftën mes Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - do të nisë orën 7:00 të mëngjesit të së premtes.

Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Katarit, Majed al-Ansari, në një konferencë për medie në Doha, tha se ndihma për në Rripin e Gazës “do të nisë të dërgohet sa më shpejt që të jetë e

mundur”.

Armëpushimi është pritur të nisë pasi u arrit marrëveshja të mërkurën, por palët ende po zgjidhin disa detaje të fundit.

Marrëveshja, që u arrit me ndërmjetësimin e Katarit, parasheh lirimin e 50 pengjeve gra dhe fëmijë që u zunë rob nga Hamasi gjatë sulmeve të 7 tetorit në jug të Izraelit.

Në këmbim, Izraeli do të lirojë rreth 150 palestinezë të burgosur.

Al-Ansari tha se grupi i parë i civilëve të marrë peng do të lirohet rreth orës 16:00. Sipas tij, do të lirohen 13 gra dhe fëmijë.

Hamasi ka marrë afër 240 pengje gjatë sulmeve të 7 tetorit që nxitën luftën në Rripin e Gazës.

Si pasojë e dhunës, 1 200 persona janë vrarë në Izrael dhe mbi 13 000 në Rripin e Gazës. Ky territor palestinez, i banuar me 2.3 milionë persona, është rrethuar nga Izraeli dhe ka qenë cak i



sulmeve të pandërprera ajrore dhe tokësore. Marrëveshja e armëpushimit

parasheh edhe lejimin që më shumë ndihmë të arrijë për palestinezët në Gazë.

Haradinaj bën thirrje që Kuvendi të hartojë një rezolutë për anëtarësimin e Kosovës në NATO

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës, ka folur për situatën e sigurisë në Kosovë dhe për paralajmërimet për

përshkallëzim të mundshëm. Sipas ish-kryeministrit të Kosovës, Haradinaj, Kuvendi i Kosovës mund t'i marrë dy-tre vendime të shpejta për ta ndihmuar Kosovën në situatën që rrezikohemi. “Çështja e sigurisë është

serioze në Kosovë e në rajon”, tha ai. Kuvendi, sipas Haradinajt, mund të aprovojë një rezolutë, përmes së cilës t'i kërkojë Qeverisë së Kosovës anëtarësimin direkt në NATO. “Jo në Partneritet për Paqe, por

anëtarësim direkt në NATO”. Sipas Haradinajt, duhet të krijohet edhe një Komision Parlamentar për NATO. “Dhe njëkohësisht të kemi një agjendë parlamentare për t'i bindur vendet skeptike në NATO që të ecim përpara”.



Flaka në Institutin e Mjekësisë Ligjore zhduki mbetjet e Adem Jasharit dhe Isa Boletinit



Prishtinë, 23 nëntor - Për shkak të një zjarri që kaploi një pjesë të Institutit të Mjekësisë Ligjore, që ende nuk dihet se çfarë e shkaktoi, meqë as policia e as Ministria e Drejtësisë nuk kanë dhënë shpjegime, Kosova ka humbur mbetjet e vetme që kishte nga dy komandantët legjendarë, Adem Jashari dhe Isa Boletini. Në vitin 2000 familja e Jasharëve dhe ajo e Boletinëve ia kishin dorëzuar shtetit të Kosovës mbetjet mortoreve të dy komandantëve dhe ato janë zhdukur pasi u dogjën dy zyra të rëndësishme brenda IML-së. Në reagimin e parë të Ministrisë u tha se, fatmirësisht, zjarri nuk ka prekur në prova apo dëme të kësaj natyre, por pasi mediet zbuluan se me këtë rast janë

djegur mustaqet e Adem Jasharit dhe gishti i Isa Boletinit, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e pyetur në seancën e Kuvendit të Kosovës, është detyruar ta pranojë. Haxhiu është arsyetuar se nuk ka pasur dijeni se ato mbaheshin në IML, duke prodhuar më pas një frazë krejtësisht të pakuptueshme, se po ta dinte do të mundësonte që ato t'i mbante shteti. E çuditshme kjo, meqë Instituti i Mjekësisë Ligjore përbën në këtë rast shtetin dhe faktikisht është institucion nën Ministrinë e Drejtësisë, dikasteri që Haxhiu e drejton. Ministrja, së cilës i ndodh për herë të dytë gjatë mandatit t'i digjet objekti i IML-së, ku ruhen prova të rëndësishme për vrasje

të dyshimta që kanë ndodhur në Kosovë dhe rezultate të ekspertizave për të tilla situata, ka refuzuar të marrë përgjegjësi politike. Veç zjarreve (i pari në mars të këtij viti dhe i dyti gjatë kësaj jave), në IML u patën zhdukur për një kohë edhe mostrat e mbetura të aktivistit Astrit Dehari, ish-anëtar i Lëvizjes Vetëvendosje, i quajtur “dëshmor i lirisë” nga qeveria aktuale. “Siç na është thënë”, filloi shpjegimin nonshalant ministrja, “në vitin 2000 familjet Boletini dhe Jashari ia kanë dhënë njërit prej ekspertëve të IML-së (mbetjet). Pra, familjet ia kanë dhënë atij dhe personi i ka mbajtur në zyrë”, vazhdoi pa u sqaruar më tepër se nëse nuk e ka ditur kur e mori vesh, meqë

tani po e di. “Po ta dija unë ato duhej t'i mbante shteti”, pohoi ministrja e shtetit, e vetëdijshme se ato mbetje në momentin kur u dogjën, pikërisht nga shteti po mbaheshin, më saktësisht nga Ministria që ajo drejton, faktikisht nga IML-ja. Përkundër se i kishte shteti, përkundër se mbaheshin nga institucioni që është në varësi të ministrisë që ajo udhëheq, Haxhiu pohoi se “nuk kam pasur informacion”. “Nuk kam pasur informacione se kanë qenë në zyrë të një prej ekspertëve të IML-së”, e përfundoi shpjegimin e saj me dy fjali. Paraprakisht ajo e inkriminoi veten duke e pranuar se beson edhe ajo që ka gjasë se zjarri në IML mund të ketë qenë i

qëllimshëm, derisa deklaronte se nuk beson se u shkaktoi nga ndonjë defekt elektrik, siç ishte dhënë sqarimi kur kishte ndodhur e njëjta në mars. “Unë kërkoj që me shpejtësi dhe pa asnjë vonesë ta themeloni Komisionin Hetimor sepse mendoj se kështu mund t'i ndihmoni Kosovës, mund t'i ndihmoni IML-së, në mënyrë që veprimet që kanë ndodhur deri më tani, të adresohen dhe nuk po shoh institucion tjetër që mund të bëjë këtë tani për tani më mirë”, pohoi ministrja pa u marrë fare me faktin se gjithçka që ka ndodhur, ka ndodhur nën udhëheqjen e saj dhe gjatë mandatit ministre. Më pas, pa e kuptuar se si e zhyste veten, tha edhe se “duket që krimi është shumë i madh (në IML)”, institucion të cilin e ka nën kontroll tash e tri vjet. Ajo vazhdoi t'ia punojë aktakuzën vetes, kur tregoi edhe se ka njohuri se çfarë ka thënë dhe si ka folur në prokurori deputeti Haki Abazi. Pasi Abazi doli në foltore dhe akuzoi Haxhiun. Ajo i tha kujdes çfarë po flet, meqë kështu thoshe edhe se ka prova për Astrit Deharin, “por kur ke shku aty mezi ke fol”. Vërejtjen ia tërhoqi edhe ish-ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahirit, pasi ky i tha se do t'i vinte turp të qëndronte edhe një minutë më shumë si ministër nëse nën mandatin e tij do të digjej IML, do t'i zhdukeshin provat Astrit Deharit dhe flakët do t'i merrnin mbetjet e Jasharit e Boletinit. “Nuk po mund të përmend edhe disa çështje të tjera sepse jemi në Kuvend”, i tha Haxhiu Tahirit duke aluduar se di diçka aq të shëmtuar për të, saqë s'mund ta thotë se “po i respektoj qytetarët e Kosovës”. || Albanianpost

Sindikata e Policisë për grabitjen në Suharekë: Organet e drejtësisë të veprojnë sipas ligjit

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Sindikata e Policëve të Kosovës ka kërkuar dënimin meritor ndaj personave që kanë sulmuar Policinë e Kosovës të mërkurën në Suharekë gjatë grabitjes së armatosur. Në një komunikatë për medie nga sindikata është thënë se

sulmet ndaj zyrtarëve policorë duhet të ndalen. “Zyrtarëve policorë u dëshirojmë shërim të shpejtë, kurse dënojmë çdo sulm ndaj zyrtarëve policorë dhe nga organet e drejtësisë kërkojmë që të veprojnë sipas ligjit ndaj kryesve të këtyre veprave penale me qëllim të parandalimit të sulmeve ndaj

zyrtarëve policorë dhe veprave të tjera penale”, thuhet në reagimin e sindikatës. Një polic është plagosur në Suharekë pasi katër persona të armatosur kanë shtënë me armë në drejtim të tij kur kryen grabitje në një argjendari të mërkurën.





ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (ZPS) KËRKON QË THAÇIT, VESELIT DHE SELIMIT
T'U PEZULLOHEN VIZITAT DHE TË GJITHA KOMUNIKIMET

Musliu: Specialja, në mungesë të provave dhe fakteve, po përdor metoda të frikshme

Zyra e Prokurorit të Specializuar ka kërkuar të enjten që Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi t'u pezullohen vizitat dhe të gjitha komunikimet, përveç me ekipin e avokatëve. Sipas ZPS-së, ata kanë shkelur urdhrat e trupit gjykues duke zbuluar identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur dhe/ose shpërndarjen e përmbytjes së dëshmisë konfidenciale për personat që i vizitojnë në Qendrën e Paraburgimit. Ndaj këtij lajmi ka pasur reagime të shumta në Prishtinë. KMDLNj ka theksuar se Specialja po vazhdon shkeljet ndaj të paraburgosurve, duke mos u pajtuar edhe me heshtjen e institucioneve të Kosovës që janë vënë në krah të kësaj gjykate. Ndërkaq deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, ka kërkuar reagim të Kuvendit të Kosovës, duke theksuar se Specialja është duke përdorur metoda të frikshme të shkeljes të të drejtave të njeriut

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 23 nëntor - Përmes një kërkesë Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar që ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, t'u pezullohen vizitat dhe të gjitha komunikimet e tjera, përveç me ekipin e avokatëve. Kjo kërkesë nga ZPS-ja është bërë nën pretendimet se ata kanë shkelur urdhrat e trupit gjykues, duke zbuluar identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur ose shpërndarjen e përmbytjes së

dëshmisë konfidenciale për personat që i vizitojnë në Qendrën e Paraburgimit. "Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi (tre të akuzuarit) kanë shkelur urdhrat e Trupit Gjykues duke zbuluar identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur dhe/ose duke shpërndarë përmbytjen e dëshmimeve konfidenciale personave që i vizitojnë ata në Qendrën e Paraburgimit", thuhet në njoftimin e Speciales. Më tej theksohet se hetimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("SPO") kanë zbuluar përpjekje të mëtejshme për t'i

penguar procedimet, duke përfshirë lëshimin e udhëzimeve se si duhet të dëshmojnë dëshmitarët dhe planifikimin e qasjeve ndaj dëshmitarëve. Nga Prokuroria është thënë se vizitorët që kanë qenë në periodha të ndryshme në Hagë ishin afuar te dëshmitarët duke synuar të komunikojnë me ta për ta penguar dëshminë e tyre. "Shumë dëshmitarë të mbrojtur në këtë rast kanë raportuar se u janë afuar personave që tentojnë të pengojnë ose ndikojnë në dëshminë e tyre. Siç përkruhet më poshtë, në një numër rastesh, këto qasje u

tregua se ishin drejtuar nga një ose më shumë nga tre të akuzuarit dhe/ose personat që i kishin vizituar ata në Hagë. Në bazë të autorizimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm, PSP-ja ka regjistruar në mënyrë të fshehtë vizita jo të privileguara të tre të akuzuarve në Qendrën e Paraburgimit ("Incizime"). ZPS-ja ka urdhëruar që të ketë monitorim aktiv (nga një folës në gjuhën shqipe) të të gjitha komunikimeve jo të privileguara të tre të akuzuarve dhe ruajtjen e atyre të dhënave deri në përfundimin e gjykimit. Prokuroria ka kërkuar që vizitat e privileguara të kufizohen vetëm për ekipin e avokatëve. Madje Prokuroria e Specializuar kërkesë tjetër e ka pasur që tre të akuzuarit të ndahen nga të paraburgosurit e tjerë që janë në Qendrën e Paraburgimit aktualisht. Për këtë çështje në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës ka reaguar deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Ganimete Musliu, e cila nuk kishte votuar në atë kohë për themelimin e Gjykatës Speciale. "Të nderuar qytetarë, sot do ta

shpreh shqetësimin tim dhe tuajin në lidhje me zhvillimet në Dhomat e Specializuara. Gjykata Speciale në Hagë, në mungesë të provave dhe fakteve, për ta fshehur motivin politik dhe dështimin, është duke përdorur metoda të frikshme të shkeljes të të drejtave të njeriut që nga fillimi i punës së kësaj gjykate e deri me vendimin e fundit për ndalimin e vizitave dhe të telefonatave të atyre që po mbahen padrejtësisht prapa grilave", ka thënë Musliu në fjalën e saj para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ajo ka bërë thirrje që ndaj këtyre vendimeve të Speciales të ketë reagim të gjithanshëm. "Po i shfrytëzoj këta tre minuta për të apeluar tek të gjitha organet kompetente, tek organizatat përkatëse, te ky Kuvend dhe te ju qytetarë të nderuar, që të reagojmë të gjithë kundër këtyre vendimeve. Kosova dhe shqiptarët asnjëherë nuk i janë trembur drejtësisë sikurse asnjëherë nuk e kanë duruar padrejtësinë", ka thënë deputetja Musliu. Ajo ka theksuar se ky Kuvend e ka votuar këtë gjykatë dhe ky Kuvend duhet i pari të reagojë

Ligji i ri për Zgjedhjet, KQZ-ja do të zhvillojë takime me kryetarët e komunave

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do të fillojë vitin e ardhshëm me një raund takimesh me kryetarët e të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Kjo iniciativë e KQZ-së vjen pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për zgjedhjet e përgjithshme, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Në mbledhjen e KQZ-së është bërë me dije se qëllimi i këtyre takimeve ndërldidhet me rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, por edhe

për t'i diskutuar përgjegjësitë ligjore dhe zbatimin e tyre. Arianit Elshani nga PDK-ja ka thënë se kryetarët e komunave do të raportojnë për punën e tyre. Përderisa Sami Hamiti nga LDK-ja ka thënë se fundviti për komunat është shumë i ngarkuar, ky takim duhet të bartet në fillim të vitit. Me 9 vota për është miratuar që takimet me kryetarët e komunave të fillojnë nga 15 janari. KQZ-ja ushtron funksionin në çdo komunë përmes zyrtarit



ekzekutiv, i cili gjatë periudhës së zgjedhjeve bëhet kryesues i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve që themelohet

kryesisht nga përfaqësues të subjekteve politike të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale. Sipas ligjit, komunat janë të obliguara t'u ofrojnë mbështetje të nevojshme KKZ-ve në kuptimin e sigurimit të hapësirave për punë, depo për materiale, transport, objekte publike për nevoja të votimit apo ambiente të tjera për organizimin e trajnimeve të komisionarëve dhe numëruesve, si dhe hapësira për adaptimin e qendrave komunale të numërimit.

Universiteti i Prishtinës paraqet kërkesë për rritje të buxhetit për vitin 2024

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**
Prishtinë, 23 nëntor - Universiteti i Prishtinës ka paraqitur kërkesat për ndarje buxhetore për vitin 2024 para Kuvendit të Kosovës në një takim me Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport. Përfaqësuesit e Universitetit, përfshirë kryesuesin e Këshillit Drejtues, Sahitin, prorektoren për Financa, Breznica-Semani dhe drejtorin për Financa, Ilir Hajdari, kanë theksuar se UP-ja ka nevojë për një buxhet që dërgon drejt zhvillimit. Ata kanë paraqitur kërkesat e tyre për një shtesë buxhetore prej 10 milionë eurosh me qëllim që të fokusohen në zhvillim. Gjithashtu, në takim u bë me dije se me një performancë financiare afër 95 për qind në vitin 2023, UP ka shënuar rritje të dukshme në disa fusha, duke theksuar se janë ndarë bursa për studentët me vlerë 10 për qind më të madhe se herët e kaluara, bursa për studentët master dhe doktoratë, bursa për studentët me aftësi të kufizuara dhe bursë vjetore për



studentë ndërkombëtarë. Po ashtu, u tha se financimi për projekte shkencore është rritur nga 8 000 në 50 000 për njësi akademike. Universiteti, gjithashtu, ka angazhuar një përpjekje të vazhdueshme për kontrollin financiar, duke punësuar pikat kyçe që ushtrojnë kontroll në administratë si: Funksionimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe funksionimi i Departamentit të Zyrës Ligjore. Po me rritjen e buxhetit planifikohen bursa vjetore për studentët në programet që vazhdimisht po bie interesimi, si: Bujqësi dhe Veterinari, Gjuhë Shqipe, Matematikë etj. Megjithatë, zyrtarët e UP-së theksuan se buxheti aktual nuk plotëson nevojat e tyre për investime kapitale, digjitalizim, shkëmbim të stafit akademik dhe studentëve, salla sportive dinjitoze, biblioteka të hapura dhe të mbyllura, salla konferencash dhe parqe për studentë. Zyrtarët e UP-së thanë që presin që buxheti të ketë ndryshime në mënyrë që fokusi përfundimisht të kthehet nga zhvillimi.

kur shkelen të drejtat themelore të njeriut. “Prandaj është koha e fundit të mendojmë nëse dëshirojmë të heshtim, të nënshtrohemi dhe të turpërohemi, apo të tregojmë se kemi krenari shtetërore e kombëtare dhe që kemi ligje e Kushtetutë, e t'u themi stop padrejtësive në emër të shtetit dhe në emër të popullit. Nëse keni fakte vazhdoni, por nëse nuk keni ndaluni, sepse më mirë është të ndaleni sesa të krijoni precedentë të paparë në historinë e gjyqësisë. Ma gjeni një burg në botë që bën shkelje kaq flagrante të të drejtave të njeriut, përveç burgut të Guantamos”, ka theksuar deputetja Musliu. Në lidhje me këtë vendim të Speciales kishte reaguar më herët edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj). “Sipas informatave të

KMDLNj-së, ndaj pengjeve që po mbahen në Qendrën e Paraburgimit në Hagë, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës, si të paraburgosur, duke u gjykuar dhe në vuajtje të dënimit, kohën e fundit u ishin nënshtruar disa kufizimeve në fushën e informimit e që përfundoi me ndërprerjen e paparalajmëruar të vizitave familjare dhe personave të tjerë që kishin marrë pëlqimin nga autoritetet e Gjykatës Raciste Speciale për vizita. Edhe komunikimi tjetër ishte ndërprerë, pa dhënë ndonjë sqarim. Vizitat ishin ndërprerë krejtësisht në kohën e pandemisë mirëpo jo edhe komunikimet me familjarë dhe të tjerë përmes telefonit dhe formave tjera elektronike”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se shkeljet që u bëhen

Behrami: Heshtja e Qeverisë dhe opozitës për ngjarjet në Hagë është e frikshme

Ish-këshilltari i ish-presidentit Hashim Thaçi, Artan Behrami, ka thënë se heshtja e qeverisë dhe opozitës për ngjarjet në Hagë është e frikshme. “Ndërhyrje në drejtësi nuk qenka kur Qeveria e Serbisë dërgon dezinformata te Prokuroria e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Ndërhyrje në drejtësi nuk qenka kur BIA serbe paguan, kërcënon, shantazhon dhe rekruton dëshmitarë kundër krerëve të UÇK-së. Ndërhyrje në drejtësi nuk qenka kur kryetarja dhe kryeprokurori (ish) takojnë diplomatë dhe thonë se krerët e UÇK-së do të dënohen!

Paramendoni, as Sllobodan Millosheviqin nuk e kanë përgjuar dhe nuk ia kanë publikuar bisedat. Por, atij nuk kanë guxuar, sepse shtetin, opozitën, e ka pasur me vete! Deri sa këta në Kosovë, fatkeqësisht, shtetin e kanë kundër”, ka shkruar Behrami në “Facebook”.

në vazhdimësi pengjeve nga Kosova në Hagë, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë, duhet të trajtohen seriozisht nga Komiteti Ndërkombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin

Degradues për faktin se askujt nga Kosova nuk i lejohet t'i vizitojë brenda hapësirës së burgut për ta parë trajtimin e tyre dhe kushtet fizike. “KMDLNj fuqishëm dënon shkeljet që Gjykata Speciale Raciste po ua

bënë pengjeve të Hagës, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë sikur edhe heshtjen e institucioneve të Kosovës që, me dashje apo pa dashje, janë vënë në krah të kësaj gjykatë”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Haradinaj: AAK-ja po fuqizohet me energji dhe përkushtim më të fuqishëm se kurrë

ISTOG, 23 NËNTOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, bashkë me deputetët Bekë Berisha e Shemsedin Dreshaj, në vazhden e takimeve me strukturat e partisë në të gjithë Kosovën, ka qëndruar në Istog. Në takim ishte edhe kandidati për kryetar të Istogut nga

AAK, Ukë Blakaj. Haradinaj ka bashkëbiseduar për zhvillimet e fundit në vend, me theks të veçantë në aspektet organizative në Aleancë. “Kolegëve u shpreha falënderimin për përkushtimin dhe u shpreha urimet më të mira për suksese në raport me sfidat që kemi përpara.

Aleanca po fuqizohet me një energji dhe përkushtim më të fuqishëm se kurrë. Jemi të gatshëm që vendit t’ia kthejmë perspektivën për zhvillim dhe integrim në NATO dhe BE. Kjo na inkurajon të punojmë pandalshëm në shërbim të vendit!”, ka thënë Haradinaj.



LDK-ja bën homazhe në 23-vjetorin e vrasjes së Xhemail Mustafës



PRISHTINË, 23 NËNTOR - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, me bashkëpunëtorë, me kryetarin e degës në Podujevë, Ekrem Hyseni dhe strukturat e degës, kanë bërë homazhe pranë varrit të Xhemail Mustafës në 23-vjetorin e vrasjes së tij.

Kryetari Abdixhiku veprimtarin e madh Xhemail Mustafa e cilësoi ikonë të lëvizjes politike të viteve '90. “Xhemail Mustafa ishte prijatar i shumë proceseve në kohët më të vështira të Kosovës, mik i ngushtë i presidentit Ibrahim Rugova e këshilltar politik, atdhetar, profil

shumëdimensional i shkrimtarit, publicistit e gazetarit. Roli, po ashtu, edhe kontributi i tij në rrugën për liri dhe pavarësi, është i paharrueshëm për LDK-në dhe historinë e Kosovës. Vrasja e Xhemail Mustafës vazhdon të mbetet ende goditje e rëndë për familjen, Lidhjen Demokratike dhe demokracinë e Kosovës”, ka theksuar kryetari Abdixhiku, duke shtuar se Lidhja Demokratike e Kosovës nuk do të ndalet asnjëherë së kërkuari për zbardhjen e vrasjes së Xhemail Mustafës, por edhe bashkëpunëtorëve të tij.

Përfundon trajnimi “Avancimi i njohurive financiare” në Drenas në mbështetje të bizneseve të grave

DRENAS, 23 NËNTOR - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), në bashkëpunim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik në Drenas, ka organizuar trajnim me moton “Avancimi i njohurive financiare”. Në përmbylljen e këtij trajnimi, të pranishëm ishin edhe kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, drejtori gjeneral i FKGK-së, Besnik Berisha,

menaxherja për marrëdhënie me publikun, Anita Toçi, si dhe drejtoresha e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Agnesë Kastrati-Bucolli. Këto trajnime janë komponentë e skemës garantuese të FKGK-së “Dritarja për gra në biznes” mbështetur nga Banka Botërore. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte avancimi i njohurive financiare të cilat pritet t’i mbështesin

bizneset me pronare gra në mënyrë që t’i zgjerojnë njohuritë për financat e biznesit të tyre.

Pas përfundimit të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit u pajisën me vegëlën e quajtur “Business Help”, që do t’u ndihmojë në mirëmbajtjen e të dhënave të biznesit të tyre, si dhe u bë shpërndarja e mirënjohjeve për pjesëmarrësit.



Nis pilotprojekti i strategjisë për riciklimin e mbeturinave në Podujevë



PODUJEVË, 23 NËNTOR - Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje e Mjedisit në Podujevë, në bashkëpunim me kompaninë “Natyra”, ka filluar zbatimin e pilotprojektit të Strategjisë për riciklimin e mbeturinave në Shkollën e Mesme të Ulët “Ibrahim Rugova”. Kjo nismë vjen në kuadër të bashkëpunimit me GIZ-in gjerman, përmes konsulentit i cili ofron praktika evropiane për menaxhimin e

mbetjeve të ndryshme të mbeturinave.

Ligjëratat u mbajtën me mësimdhënësit për ndarjen e letërës, plastikës, metalit dhe për format e përpunimit të saj më tej, që këto njohuri ata pastaj t’i transmetojnë te grupi i gjelbër i shkollës i cili merret me çështje të mjedisit dhe tek të gjithë nxënësit. Qëllimi i këtij projekti është funksionalizimi i sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e

mbetjeve në komunën e Podujevës, e cila pason qarkoren e ekonomisë, duke ndjekur praktikën e qytetit të binjakëzuar Velbert.

Riciklimi do të jetë: Letër dhe karton në koshin e kaltër.

Plastika, qelqi dhe metali në koshin e verdhë (të cilat do të mblidhen nga kompania e mbeturinave “Natyra”), mbetjet e përziera në koshin e zi, të cilat do të mblidhen nga KRM “Pastrimi”.

Përfundon rregullimi me kubëza në 21 segmente rrugore në Rahovec

Rahovec, 23 nëntor - Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës publike, ka

përfunduar rregullimi me kubëza i 21 segmenteve rrugore në qytetin e

Rahovecit.

Gjatësia në total e këtyre rrugëve është 1 780 metra.

Po në rrugën “Tafil Zyberaj” ka përfunduar edhe trotuari në gjatësi prej 910 metrash.



Miratoohen disa marrëveshje ndërkombëtare, PDK-ja s'merr pjesë në votim

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës ka nisur të enjten miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në votimin e tyre kanë marrë pjesë LDK-ja dhe AAK-ja, por jo edhe PDK-ja. Qëndrimi i kësaj partie nuk ka ndryshuar meqë, siç thanë nga ky subjekt, Kosova po vazhdon të mbetet e sanksionuar nga Bashkimi Evropian. Marrëveshja e parë e cila është miratuar është “Rehabilitimi i linjës hekurudhore 10B”. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka theksuar se vendi po vazhdon të jetë nën sanksione të BE-së. “Si grup parlamentar i PDK-së në asnjë rrethanë nuk pajtohem që sot të vijmë për diskutim dhe për votim marrëveshjet e tjera ndërkombëtare. Si grup parlamentar i PDK-së nuk do t'i votojmë, sepse vendi është nën masa dhe nën sanksione pikërisht nga BE-ja”, u shpreh ai. Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se do të



votojnë këto marrëveshje ndërkombëtare. “Qëndrimi ynë politik për të mos votuar marrëveshjet ndërkombëtare është për t'u treguar se sa e rëndësishme është opozita dhe sa i rëndësishëm është debati parlamentar dhe ndërtimi i konsensusit për çështje të brendshme, jo për të dëmtuar të mirën publike... Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të votojë. Po ashtu, ju them se si grup parlamentar kemi diskutuar edhe me deputetin Haki Abazi. Edhe ai është zotuar paraprakisht që do ta japë votën, për të vetmen arsye, me pa fuqinë opozitare që e ka”, ka deklaruar Tahiri. Kuvendi ka miratuar marrëveshjen e kredisë dhe projektit ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, KOSTT (Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh. a.) dhe KFW, Frankfurt Am Main (KFW) për Projektin -

Zhvillimi i sektorit të energjisë VII - përmirësimi i rrjetit të transmetimit. Po ashtu, është miratuar edhe marrëveshja e kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Ngrohtorja solare e Prishtinës”, Marrëveshja për bashkëfinancimin e bursave të arsimit të lartë në nivelin master në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe

Inovacionit dhe Ambasadës së Francës në Prishtinë. Kuvendi ka votuar edhe marrëveshjen në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për projektin mbështetja për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve.

Ambasadori gjerman i gëzohet ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka përshëndetur miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvendin e Kosovës. “Lajme të mira për Kosovën. Më në fund iu dha drita e gjelbër marrëveshjeve të rëndësishme ndërkombëtare, të arritura sot me konsensus ndërpartiak në Kuvend. Këto do t'i sjellin dobi popullit dhe tërë vendit”, ka shkruar Rohde në “X”.

Kurti pret përfaqësues të organizatës CSSP, diskutojnë për dialogun e brendshëm me komunitetin serb

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim Christoph Luettmann dhe Simone Ceresa nga organizata CSSP - Berlin Center for Integrative Mediation. “Temë e diskutimit ishin aktivitetet e zhvilluara në kuadër të dialogut të brendshëm dhe hapat e ndërmarrë gjatë këtyre 32 muajve qeverisje për ndërtimin e besimit ndërmjet qytetarëve tanë nga komuniteti serb dhe qeverisë”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Në njoftim theksohet se u cilësua i suksesshëm procesi i rifillimit të verifikimit të diplomave dhe krijimi i bazës ligjore për verifikimin e diplomave të shkollave të mesme. “Gjithashtu, pozitive kanë qenë takimet që ka mbajtur kryeministri me shoqërinë civile serbe në Kosovë dhe vizitat e tij në lokalitetet e



banuara kryesisht nga komuniteti serb”, thuhet në njoftimin e qeverisë. Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë për Komunitete dhe Kthim ka ndarë në muajin shtator të këtij viti një fond prej 3 milionë eurosh për OJQ-të, bizneset e vogla dhe fermerët, me disa prej tyre edhe është takuar kryeministri Kurti gjatë nënshkrimit të kontratave për

grantet. Gjatë bisedës u përmendën dhe emërimet e serbëve në pozita të larta të institucioneve siç është rasti i Srdjan Sentic, i zgjedhur zëvendës i Avokatit të Popullit dhe zgjedhjes brenda bordit të Trepçës të një anëtari nga komuniteti serb, Dragisa Krstovic. Kryeministri Kurti ka theksuar se buxheti për vitin 2024 për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim është rritur për 51 për qind. Ai shprehu optimizëm për zhvillimin e ndërtimit të besimit mes qytetarëve nga komuniteti serb dhe qeverisë sepse, sipas tij, qeveria që drejton është aty për ta, dhe me gatishmëri të plotë për t'i vazhduar aktivitetet e dialogut të brendshëm e për t'i dëguar kërkesat dhe propozimet e të gjithë qytetarëve pa dallim.

Përparimi i Kosovës dhe Malit të Zi përforcohet në rrugëtimin e përbashkët drejt BE-së

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim të ngarkuarin me Punë në Ambasadën e Malit të Zi për Kosovë, Bernard Çobaj. Bislimi ka thënë se përparimi i dy vendeve përforcohet përmes fuqizimit të bashkëpunimit në kuadër të rrugëtimit të vendeve tona

drejt Bashkimit Evropian. Ndërkaq Çobaj ka folur mbi angazhimin e përkushtimin e tij në rritjen e bashkëpunimit, ku veçoi posaçërisht aktivitetet kulturore të zhvilluara së fundmi në ndërveprim mes palëve. Në këtë prizëm u bisedua edhe mbi marrëdhëniet bilaterale dhe për bashkëpunimin e fuqizuar përmes marrëveshjeve e

projekteve që prekin infrastrukturën lidhëse mes dy shteteve, por edhe fushën e ekonomisë dhe turizmit. Më tej, palët diskutuan mbi zhvillimet e fundit dhe bashkëpunimin rajonal. Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi të ngarkuarin me Punë në Ambasadën e Malit të Zi, Bernard Çobaj, për bisedën dhe bashkëpunimin e frytshëm.



Murati thotë se vitin e ardhshëm komunat do të kenë mbështetje rekord me buxhet

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, është zotuar se për vitin 2024 komunat do të kenë mbështetje rekord me buxhet.

Sipas tij, kjo vjen si rezultat i efikasitetit të Qeverisë së Kosovës për të rritur të hyrat, të cilat pastaj mund të shpërndahen në formë të

granteve për komunat. “Ecuria e buxhetit të ndarë për komunat, nëpër vite, si dhe rritja vjetore”, ka shkruar Murati në “Facebook”, ku ka

publikuar edhe një grafikë në të cilën është paraqitur buxheti që u është ndarë komunave në katër vitet e fundit.



Mbahet trajnimi për bizneset e sektorit të bujqësisë

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, në bashkëpunim me Ambasadën Hungareze në Kosovë, kanë organizuar trajnim për bizneset e sektorit të bujqësisë në vend. Qëllimi i këtij trajnimi ishte informimi i bizneseve anëtare të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë lidhur me drejtimet e zhvillimit në Bashkimin Evropian, sëmundjet kritike të bimëve në disa kultura të përzgjedhura, përfshirë produktet si luledielli e misri, po ashtu u paraqitën mundësitë e financimit të BE-së në Kosovë për kulturat bujqësore dhe më gjerë. Hapja e takimit është bërë nga drejtoresha e Dhomës së Tregtisë, Zana Beqiri, e cila ka falënderuar Ambasadën Hungareze për përkrahjen dhënë bizneseve të Kosovës. Ndërsa në një fjalim rasti, anëtar i Bordit i DHTIK-së, Hamdi Malushaj, ka theksuar se Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka kënaqësinë që në bashkëpunim me Ambasadën e Hungarisë po ofron edhe një trajnim të denjë për bizneset anëtare të Dhomës, nga i

cili do ta kenë mundësinë të përfitojnë njohuri profesionale si dhe të informohen nga afër për mundësitë e përfitimeve financiare nga Bashkimi Evropian. Ambasadori i Hungarisë në Kosovë, Bela Bozsik, ka potencuar faktin se kompanitë e universitetet hungareze dhe të Kosovës kanë një marrëdhënie të gjatë në fushën e bujqësisë. Bozsik ka thënë se Hungaria kontribuon në garantimin e sigurisë së Kosovës dhe promovon qasjen e Kosovës në Bashkimin Evropian. Në këtë trajnim, për t'i njoftuar të pranishmit lidhur me drejtimet e zhvillimit në BE, sëmundjet e produkteve bujqësore si dhe fondeve të përcaktuara nga BE për sektorin e bujqësisë, ishin të pranishëm bashkëpunëtorë kërkimorë nga Universiteti i Hungarisë, Fakulteti i Hortikulturës dhe Shkencave të Jetës (MATE) si Gabor Kollanyi, Arbnora Berisha dhe Monika Kocsis-Kiss. Po ashtu, interesimi i bizneseve për të qenë pjesë e këtij trajnimi ishte i lartë.



Katër kompani nga Kosova po marrin pjesë në panairin më të madh të modës në Izmir të Turqisë



PRISHTINË, 23 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka mbështetur katër kompani nga Kosova që po marrin pjesë në panairin e modës “IF Wedding Fashion Izmir Fair 2023”. Përmes një njoftimi për medie, MINT ka treguar se Kosova ka siguruar hapësirën për ekspozimin e punimeve prej 312 metrash katrorë në panairin e modës në Izmir për “Walone Fashion Group”, “Minna”, “Drenusha Xharra” dhe “Tabja”. “Panairi iu shërben bizneseve vendore për krijimin e lidhjeve të reja dhe rritjen e eksportit, e që këtë vit Kosova ka shënuar rekord në eksport falë politikave mbështetëse ndaj bizneseve që i ka aplikuar Qeveria e Republikës së Kosovës. Në panairin e modës kompanitë nga Kosova do të realizojnë edhe takime B2B me

investitorët dhe blerësit potencialë për industrinë e tekstilit”, thuhet në njoftim. MINT ka njoftuar se në Izmir të Turqisë janë ekspozuar edhe broshurat me informacionet për të bërë biznes në Kosovë. “Në shtandin e Republikës së Kosovës janë të ekspozuara broshurat me informacione që tregojnë për klimën e të bërit biznes, potencialin dhe lehtësirat që ofron Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për investitorët potencialë. Po ashtu, vizitorët po njoftohen për potencialin që ka Kosova, sidomos në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë, ku shumë biznese të huaja kanë hapur përfaqësitë për shkak të klimës së favorshme të të bërit biznes”, ka njoftuar MINT. Panairi “IF Wedding Fashion Izmir FAIR 2023” mbahet nga data 21 deri më 24 nëntor dhe Kosova është në mesin e 238 kompanive që po marrin pjesë nga e gjithë bota.

Kompanitë e Kosovës sjellin punëtorë nga Azia, ata ikin drejt vendeve evropiane

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Njëmbëdhjetë punëtorë nga Bangladeshi, të rekrutuar për ta adresuar mungesën e fuqisë

punëtore në Kosovë, “u zhdukën” pas vetëm një dite në punë në kompaninë “Dino” në Lipjan, raporton REL.

Në Kosovë është rritur numri i punëtorëve të huaj njëjtë me kërkesën e kompanive të Kosovës për të sjellë punëtorë

nga shtetet aziatike. Por, vetë punëtorët nga Azia, Kosovën e shohin vetëm si vend transit për në vendet evropiane.



Murati thotë se vitin e ardhshëm komunat do të kenë mbështetje rekord me buxhet

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, është zotuar se për vitin 2024 komunat do të kenë mbështetje rekord me buxhet.

Sipas tij, kjo vjen si rezultat i efikasitetit të Qeverisë së Kosovës për të rritur të hyrat, të cilat pastaj mund të shpërndahen në formë të

granteve për komunat. “Ecuria e buxhetit të ndarë për komunat, nëpër vite, si dhe rritja vjetore”, ka shkruar Murati në “Facebook”, ku ka

publikuar edhe një grafikë në të cilën është paraqitur buxheti që u është ndarë komunave në katër vitet e fundit.



Mbahet trajnimi për bizneset e sektorit të bujqësisë

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, në bashkëpunim me Ambasadën Hungareze në Kosovë, kanë organizuar trajnim për bizneset e sektorit të bujqësisë në vend. Qëllimi i këtij trajnimi ishte informimi i bizneseve anëtare të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë lidhur me drejtimit e zhvillimit në Bashkimin Evropian, sëmundjet kritike të bimëve në disa kultura të përzgjedhura, përfshirë produktet si luledielli e misri, po ashtu u paraqitën mundësitë e financimit të BE-së në Kosovë për kulturat bujqësore dhe më gjerë. Hapja e takimit është bërë nga drejtoresha e Dhomës së Tregtisë, Zana Beqiri, e cila ka falënderuar Ambasadën Hungareze për përkrahjen dhënë bizneseve të Kosovës. Ndërsa në një fjalim rasti, anëtari i Bordit i DHTIK-së, Hamdi Malushaj, ka theksuar se Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka kënaqësinë që në bashkëpunim me Ambasadën e Hungarisë po ofron edhe një trajnim të denjë për bizneset anëtare të Dhomës, nga i

cili do ta kenë mundësinë të përfitojnë njohuri profesionale si dhe të informohen nga afër për mundësitë e përfitimeve financiare nga Bashkimi Evropian. Ambasadori i Hungarisë në Kosovë, Bela Bozsik, ka potencuar faktin se kompanitë e universitetet hungareze dhe të Kosovës kanë një marrëdhënie të gjatë në fushën e bujqësisë. Bozsik ka thënë se Hungaria kontribuon në garantimin e sigurisë së Kosovës dhe promovon qasjen e Kosovës në Bashkimin Evropian. Në këtë trajnim, për t'i njoftuar të pranishmit lidhur me drejtimit e zhvillimit në BE, sëmundjet e produkteve bujqësore si dhe fondeve të përcaktuara nga BE për sektorin e bujqësisë, ishin të pranishëm bashkëpunëtorë kërkimorë nga Universiteti i Hungarisë, Fakulteti i Hortikulturës dhe Shkencave të Jetës (MATE) si Gabor Kollanyi, Arbnora Berisha dhe Monika Kocsis-Kiss. Po ashtu, interesimi i bizneseve për të qenë pjesë e këtij trajnimi ishte i lartë.



Katër kompani nga Kosova po marrin pjesë në panairin më të madh të modës në Izmir të Turqisë



PRISHTINË, 23 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka mbështetur katër kompani nga Kosova që po marrin pjesë në panairin e modës “IF Wedding Fashion Izmir Fair 2023”. Përmes një njoftimi për medie, MINT ka treguar se Kosova ka siguruar hapësirën për ekspozimin e punimeve prej 312 metrash katrorë në panairin e modës në Izmir për “Walone Fashion Group”, “Minna”, “Drenusha Xharra” dhe “Tabja”. “Panairi iu shërben bizneseve vendore për krijimin e lidhjeve të reja dhe rritjen e eksportit, e që këtë vit Kosova ka shënuar rekord në eksport falë politikave mbështetëse ndaj bizneseve që i ka aplikuar Qeveria e Republikës së Kosovës. Në panairin e modës kompanitë nga Kosova do të realizojnë edhe takime B2B me

investitorët dhe blerësit potencialë për industrinë e tekstilit”, thuhet në njoftim. MINT ka njoftuar se në Izmir të Turqisë janë ekspozuar edhe broshurat me informacionet për të bërë biznes në Kosovë. “Në shtandin e Republikës së Kosovës janë të ekspozuara broshurat me informacione që tregojnë për klimën e të bërit biznes, potencialin dhe lehtësitat që ofron Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për investitorët potencialë. Po ashtu, vizitorët po njoftohen për potencialin që ka Kosova, sidomos në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë, ku shumë biznese të huaja kanë hapur përfaqësitë për shkak të klimës së favorshme të të bërit biznes”, ka njoftuar MINT. Panairi “IF Wedding Fashion Izmir FAIR 2023” mbahet nga data 21 deri më 24 nëntor dhe Kosova është në mesin e 238 kompanive që po marrin pjesë nga e gjithë bota.

Kompanitë e Kosovës sjellin punëtorë nga Azia, ata ikin drejt vendeve evropiane

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Njëmbëdhjetë punëtorë nga Bangladeshi, të rekrutuar për ta adresuar mungesën e fuqisë

punëtore në Kosovë, “u zhdukën” pas vetëm një dite në punë në kompaninë “Dino” në Lipjan, raporton REL.

Në Kosovë është rritur numri i punëtorëve të huaj njëjtë me kërkesën e kompanive të Kosovës për të sjellë punëtorë

nga shtetet aziatike. Por, vetë punëtorët nga Azia, Kosovën e shohin vetëm si vend transit për në vendet evropiane.



Himara dhe Mirëdita përballë helenizimit dhe arabizimit!



Dr. Simon PUTA / Kirurg dhe ish-deputet i Parlamentit të Shqipërisë

Memoriali i vendosur në qëndrën e Bashkisë Fushë-Arrëz, i cili i kushtohet Qeverisë së Përkohshme Shqiptare që u krijua me 27 prill 1911, u lye me bojë të zezë nga një dorë e panjohur. Po çfarë është Qeveria e Përkohshme e asaj kohe? Ajo ishte e para qeveri shqiptare që ngriti flamurin kombëtar (Qeveria e Vlorës ishte e dyta) dhe kërkoi pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria Turke. Megjithëse u krijua në Mirditë, si vatër e lëvizjes kombëtare që është kjo trevë, ajo nuk kishte përmasa lokale. Në këtë qeveri ishin krerët e veriut të Shqipërisë, katolikë dhe myslimanë dhe qëllimi i saj ishte që të krijohet një bërthamë kombëtare e cila do të vërë në levizje mbarë shqipërinë. Hedhja e bojës mbi memorialin e kushtuar kësaj ngjarje madhore është thjeshtë një veprim antikombëtar. Për çudi i, deri më sot asnjë reagim zyrtar, asnjë hetim, asnjë lajm nga mediat, asnjë qëndrim nga elita politike. Bëhet bujë në media nëse një shtëpi prostitucioni punon pa

liçensë, bëhet lajm edhe nëse një top modele qenka bërë xheloze për bashkëjetuesin e saj, madje shkruhet edhe për një zonjë VIP që ka humb qenin e saj të racës, ndërsa për njollosjen e vlerave kombëtare heshtet. Mund të justifikohen duke thënë se është vepër e njonjë të dehuri apo e ndonjë psikopati. Por përse nuk kapen!? Njerëz të tillë është e lehtë t’i zbulosh, se nuk dijnë të fshihen. Nëse nuk kapen atëherë problem është më i rëndë.

Ka kohë që mirdita provokohet. U provokua në Bushat, u provokua për kalatë në Shkodër e Lezhë, u provokua me kërkesën për të ndërtuar një xhami në Rrëshen, u provokua me flamurin turk në Qafë-Mollë, dhe tani njollosja e memorialit. Përse veprohet kështu?

Mirëdita erdhi nga mesjeta në ditët tona si e vetmja principatë shqiptëtare, e cila nuk kishte lejuar asimilimin e asnjë elementi kombëtar apo trashëgimor. Ajo nuk turqizoi e arabizoi emrin e njerëzve e të vendeve, i qëndroi besnike riteve dhe traditave shqiptëtare, mbajti lart flamurin e Gjergj Kastriotit dhe nuk i tradhëtoi të parët e saj dymijëvjeçarë për të marrë fenë e zakonet e pushtuesit shekullor. Bijtë që Mirëdita i dhuroi kombit ishin Shqipëtarë të vërtetë, të trajnuar shqiptarisht, pa asnjë ndikim turkoshak, duke i qëndruar besnike kombit në gjithcka.

E bash sepse, sic thotë edhe profesori i nderuar Neritan Ceka



se „Mirëdita ashtë zemra e një kombi që pulson“, bash për këtë ashtë ndarë nga Ahmet Zogu, u nda edhe më tepër gjatë diktaturës hoxhiane dhe tani mbeti e ndarë për shkak të reformës territoriale. Po edhe

kështu e ndarë Mirëdita frymëzon: Frymëzon forcë, frymëzon atdhetarët, frymëzon identitet kombëtar. Por Mirëdita edhe gjyon në heshtje. Ajo është si një pasqyrë ku secili sheh vlerat e veta si njeri e si atdhetar. Prandaj

e kanë halë në sy neaotomanët e sotëm. Prandaj sulmojnë, provokojnë, tërhiqen, sulmojnë përsëri, njollosin historinë deri në pambarim. Tani sulmuan në periferi të Mirëditës, kur do të sulmojnë në qendër të saj?

Atë që nuk arritën ta bëjnë për 6 shekuj, që ta turqizojnë dhe arabizojnë, duan ta bëjnë me mjete demokratike.

Po çlidhje ka rasti i Mirëditës me Himarën? Himara është autoktone shqiptëtare, të cilën duan ta helenizojnë. Është ngrit në këmbë e gjithë qeveria e fqinjit tonë jugor në mbrojtje të Bejlerit. A nuk pati deklaruar Bejleri gjatë fushatës se do ta helenizojë Himarën!? E si bashki Helene, në normat demokratike, “sipas kartës së Helsinkit” do të bëhet referendum e... mirupafshim Himarë.


Si të tentosh të arabizosh Mirëditën apo të tentosh të helenizosh Himarën është e njëjta gjë; nuk mbeten Shqipëtarë. A nuk është tradhëti kombëtare njëjloj si të tentosh të dhurosh 300 km2 det. E në akt akuzë Bejleri rrezikon të dënohet vetëm për blerje votash (njëjloj si kafet e Nexhmies) e jo për dëmin që tenton t’i bëjë atdheut.

Së fundi ngjarjet në Himarë dhe Fushë-Arrëz i bënë edhe situatë e ndikimit Rus në Ballkan dhe „miqtë jo të paktë që rusët kanë në Shqipëri“. Koinçidencë eçuditshme është se të dy bashkitë, e Himarës dhe Fushë-Arrëzit janë fituar nga foltorja.



Dr. Eqrem Zenelaj dhe Dod Luli nga Mirdita





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ujkani: Nuk është koha të dorëzohemi

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll pati një fushatë zhgënjyese në kualifikimet për Kampionatin Evropian "Euro 2024". Ish-kapiteni i "dardanëve", Samir Ujkani, që u pensionua pak ditë më

parë dhe që u emërua zëvendësudrejtor në përfaqësuese, ka folur rreth dështimit të Kosovës në kualifikuese, ku deklaroi se nuk është koha të dorëzohen dhe të shikohet e ardhmja më vetëbesim. "Po e

përmbylim një vit jo të lehtë për ekipin tonë kombëtar, gjatë të cilit patëm pritshmëri të mëdha, por nuk arritëm t' përmbushim ato, përkundër dëshirës së flaktë dhe angazhimit të madh të gjithsecilit prej

nesh. Megjithatë nuk është koha të dorëzohemi, por të shohim përpara me më shumë vetëbesim, edhe me më shumë përgjegjësi nga të gjithë ne që jemi pjesë e ekipit kombëtar", ka thënë Ujkani.



Batatina vetëkandidohet për trajner të Kosovës, opsion edhe Daja e De Biasi

Tahir Batatina i Llapit është vetëkandiduar për trajner të Kosovës. Strategu llapjan është i bindur se i plotëson kushtet që të jetë në krye të "dardanëve". Në listën e gjerë, që po përmendën për pozitën e përzgjedhësit, janë edhe Gianni De Biasi dhe Ilir Daja

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Ka mjaftuar zyrtarizimi i largimit të Primoz Glihas nga Përfaqësuesja e Kosovës në futboll për të qarkulluar emra të ndryshëm për të qenë në krye të "dardanëve". Përveç emrave të ndryshëm, emrat më të lakuar janë ai i Gianni De Biasit dhe Ilir Dajës.

Trajneri De Biasi ishte trajner i Shqipërisë, i cili e kualifikoi kombëtaren shqiptare në "Euro 2016", ndërsa tashmë është trajner i lirë për faktin se ndërpreu bashkëpunimin me Azerbajxhanin. Në anën tjetër është emri i trajnerit të Ballkanit, Ilir Daja, që ka bërë histori me suharekasit, duke fituar dy herë titullin e kampionit në Kosovë dhe duke

siguruar fazën e grupeve në Ligën e Konferencës. Nëse Federata e Futbollit e Kosovës arrin një marrëveshje eventuale duhet ta presë përfundimin e edicionit 2023/2024 për ta zyrtarizuar kur trajnerit shqiptar i përfundon kontrata me Ballkanin. Emri më i ri dhe i vetëkandiduari për pozitën e përzgjedhësit është Tahir Batatina. Ky i fundit nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka pyetur se çka duhet të arrijë ai personalisht me shumë për të merituar që t'i besohet detyra e përzgjedhësit. "Nuk di se çfarë duhet të bëj më shumë si trajner me 10 vjet karrierë, punë, organizim, disiplinë, trofe dhe lojtarë të trajnuar e të përgatitur profesionalisht duke iu besuar në moshë të re e duke i ngritur deri të Përfaqësuesja. A mund të më tregojë dikush se



çfarë lideri duhet me qenë? A mund ta di se cilat janë kriteret për një selektor? Çfarë duhet të bëjmë më shumë për të na dhënë besimin? A nuk po e duam vetë kualifikimin apo nuk po u besojmë njerëzve tanë?", ka shkruar Batatina, i cili më pas ka kërkuar që askush të mos shkelë mbi njohuritë e trajnerëve vendorë. Sipas trajnerit aktual të Llapit, trajnerët vendorë kanë merita të mëdha për avancimin e Superligës dhe nxjerrjen e shumë talentëve që tashmë janë pjesë e "dardanëve": Muhamet Hyseni, Qëndrim Zyba, Lumbardh Dellova dhe Ilir Krasniqi. "Na duhet energji pozitive dhe njerëz me ide për të ardhmen që dhanë gjithçka për vendin dhe atdheun, përndryshe nuk ka zgjidhje, vetëm katandisje e rezultate dëshpëruese. Me ty Kosovë çdoherë - në ditë të mira e të vështira...", ka përfunduar Batatina. Kosova pati një fushatë zhgënjyese në kualifikueset për Kampionatin Evropian, duke i mbyllur në pozitën e parafundit me 11 pikë të grumbulluara.



Osmani, karateisteve: Jeni yjet e Kosovës

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Shtete të mëdha botërore si Anglia, Zvicra, Franca e Kazakistani iu nënshtruan Kosovës në Kampionatin Botëror të Karatesë, duke bërë që Kosova ta fitojë vendin e tretë në botë në kategorinë e vajzave, medalje kjo e para në historinë e Kosovës në

nivel të ekipeve. Karateistet Fortesa Orana, Vlora Qerimi, Hatixhe Zejnullahu dhe Albulena Gërvalla i siguruan Kosovës këtë medalje historike për të cilën ndihen tejet krenare. Për këtë arritje karateistet e Kosovës janë pritur të mërkurën nga presidentja e Republikës së

Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka thënë se ato janë yjet e Kosovës. "Triumfi në Kampionatin Botëror në Budapest shpërfaq shpirtin luftarak të karateisteve tona. Medalistet e bronzta të Kosovës janë yjet e Kosovës, që po e rritin shkëlqimin çdo ditë e më shumë", ka thënë Osmani.

Fetahu do të marrë pjesë në mbledhjen e Bordit të FIBA Evropës

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu (sot), të premten do të marrë pjesë në mbledhjen e Bordit të FIBA Evropës. Mbledhja do të mbahet në Gjenevë të

Zvicrës, derisa për të parin e basketbollit të Kosovës kjo është mbledhja e radhës që është pjesëmarrës. Kujtojmë që në maj Fetahu është zgjedhur anëtar i Bordit të FIBA Evropës, një sukses i

madh jo vetëm për basketbollin e Kosovës, por sportin e Kosovës. Në këtë mbledhje do të vendoset se ku do të organizohen Kampionatet Evropiane për grupmosha të reja si dhe FIBA

Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla të Femrat. Kosova do të marrë pjesë me U20 të meshkujt dhe U18 të femrat dhe meshkujt, si dhe me U16 në të dyja konkurrencat.



Zyba: Jap atomin e fundit për vendin tim

SUHAREKË, 23 NËNTOR - Mesfushori i Ballkanit, Qëndrim Zyba, është paraqitur për Përfaqësuesen e Kosovës në tri ndeshjet e fundit kualifikuese për

Evropian. Ai ka thënë se këto paraqitje e frymëzojnë për të punuar më shumë, derisa ka shprehur gatishmërinë të luftojë deri në atomin e fundit për Kosovën. “Fanella e ekipit

kombëtar është gjëja më me vlerë që mund ketë një futbollist në karrierën e tij. Motivin që fitova nga këto paraqitje do ta kthej në punë për të arritur sa më shumë

dhe për të synuar qëllime edhe më të mëdha. Gjithmonë i gatshëm të luftoj deri në atomin tim të fundit për vendin tim. Unë biri yt, Kosovë”, ka thënë Zyba.



Çeku: Në verën 2024 do të bëhet Master-Plani për Stadiumin Nacional e më pas do të caktohet lokacioni

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Saga e ndërtimit të Stadiumit Nacional të Kosovës duket se do të vazhdojë edhe për një kohë të gjatë. Tash e disa vjet flitet për ndërtimin e këtij stadiumi. Herë është planifikuar të ndërtohet në Korreticë të Drenasit, herë në Bërnice të Prishtinës. Gjithsesi, të gjitha këto plane kanë mbetur deri më tash “ëndra”. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka folur për “lajmi.net” lidhur me çështjen e shumëpërfolur të stadiumit. Ai ka njoftuar se në verën e vitit 2024 do të bëhet Master-Plani për stadiumin dhe më pas do të caktohet lokacioni. “Stadiumi Nacional do të ndërtohet. Është pjesë e obligimeve që kemi për Lojërat Mesdhetare që organizohen në vitin 2030. Tashmë është edhe obligim ndërkombëtar. Së pari do të bëhet Ligji për Lojërat Mesdhetare, pastaj struktura organizative për Lojërat Mesdhetare, pastaj kah vera e vitit të ardhshëm do të bëhet master-plani për stadiumin. Me Master-Plan do të caktohet edhe lokacioni, pastaj



fillon procedura e ndërtimit”, ka thënë Çeku. Kosova aktualisht e ka vetëm një stadium të kategorisë së katër që i plotëson kriteret për ndeshje ndërkombëtare. Ai është “Fadil Vokrri” në Prishtinë e që ditët e fundit është bërë lajm për të keq në medie vendore e ndërkombëtare për shkak të fushës me lloç në ndeshjet Kosovë - Izrael dhe Kosovë - Bjellorusi. Çeku me këtë rast i ka fajësuar komunën e Prishtinës dhe Federatën e Futbollit të Kosovës.

“Pamja e stadiumit ‘Fadil Vokrri’ nuk është e mirë, nuk na shërben neve. Duhet të kemi një bashkëpunim më të gjerë. Komuna dhe Federata e Futbollit e Kosovës e kanë marrë përsipër mirëmbajtjen e stadiumit dhe janë treguar të paafat. Edhe sot e përsëritim gatishmërinë tonë për ta mbështetur dhe mirëmbajtur stadiumin. Qeveria ndërton dhe investon në infrastrukturë e komunat më pas i mirëmbajnë dhe menaxhojnë. Kur nuk janë të afta, duhet të tregojnë dhe kërkojnë ndihmë”, ka përfunduar Çeku.

Duka për ‘Tuttomercatoweb’: Duam t’i kalojmë grupet e ‘Euro 2024’

TI RANË, 23 NËNTOR - Kualifikimi i Shqipërisë në finalen e Evropianit “Gjermani 2024” dhe vendi i parë në Grupin E ka bërë jehonë kudo në botë, sidomos në Itali, duke parë edhe numrin e lartë të futbollistëve me origjinë shqiptare që aktivizohen në klubet italiane. Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, ka dhënë një intervistë për median italiane “Tuttomercatoweb”, ku ka folur për arritjet e Shqipërisë në edicionin kualifikues që u kurorëzua me kualifikimin në Kampionatin Evropian “Gjermani 2024”. Kreu i qeverisë së futbollit shqiptar tregoi se si nisi gjithçka, që nga zgjedhja e trajnerit Silvino në krye të ekipit kombëtar. Presidenti Duka vlerësoi edhe lojtarët shqiptarë që aktivizohen në klubet italiane, ndërsa shtoi se nuk dëshiron që Shqipëria të përballet në grup me Italinë. “Pasi u kualifikuam trajneri ishte tejet i



gëzuar. Ai ka bërë një punë shumë të mirë, ka arritur një objektiv të madh dhe kishte shumë arsye për të festuar. Por ama ju them sinqerisht se asgjë nuk vjen rastësisht. Duhet sakrificë dhe punë e programuar, ndryshe asgjë nuk arrihet. Natyrisht, trajneri ishte regjisor, por më duhet të flas mirë edhe për Dorivën që ka luajtur në Itali. Ai është një ekspert që na ka ndihmuar shumë. Ai së bashku me Zabaletën ndërtuan një grup shumë kompakt. Mua

brazilianët nuk më kanë pëlqyer shumë si trajnerë dhe kur ma propozuan nuk isha shumë i bindur. Por ama kur e takova dhe pasi folëm për projektin, atëherë më bindi. Gjithsesi sot po flasim për një mision të përmbyshur. Edhe ai si trajner kaq mirë sa te Shqipëria nuk kishte bërë askund”, ka thënë Duka. I pari i FShF-së pastaj foli edhe për synimet e Shqipërisë. Tha hapur se synojnë të shkojnë përtej fazës së grupeve. “Tani vjen pjesa e vështirë. Do t’i takojmë ekipet e forta. Në letër arrijmë si një nga skuadrat më të dobëta, por duam të shkojmë përtej grupit. Nuk e di ku do të arrijmë, por i kemi kualitetet për të shkuar më tej. Dhe festa tashmë ka përfunduar. Ne po përgatitemi për Gjermaninë. Trajneri është i uritur. Nuk dua ta takoj Italinë. Është ekip shumë i fortë edhe pse nuk ka arritur rezultate të mira kohën e fundit”, ka deklaruar Duka.

SHKURT

Maldini: U përpoqëm të nënshkruajmë me Messin

Ish-drejtori i AC Milan, Paolo Maldini, ka konfirmuar se klubi kuqezi ka tentuar transferimin e Lionel Messit sa ishte pjesë e PSG-së. “Ne u përpoqëm të nënshkruajmë me Leo Messin. Unë e doja atë. E thirrëm, por pas 10 ditësh kuptuam se ishte e pamundur. Ai është lojtar i mrekullueshëm”, ka thënë legjenda e Milanit, Paolo Maldini.

FIFA dhe federata spanjolle kompensojnë Barcelonën për lëndimin e Barçës

Gavi pritet të mungojë për të paktën shtatë muaj pas dëmtimit të rëndë që pësoi në gju gjatë ndeshjes së Spanjës kundër Gjeorgjisë. Sipas medieve vendase, federata spanjolle pritet t’i japë Barcelonës një shumë prej 7,5 milionë eurosh, duke dashur ta dëmshpërblejë në këtë mënyrë klubin katalanas. Një shumë e cila pritet t’u shtohet tre milionëve që FIFA do t’i japë Barcelonës. Sipas Rregullores së FIFA-s, konfederata botërore është e detyruar t’i paguajë skuadrat kur një futbollist dëmtohet rëndë në masën që duhet të jetë jashtë fushës për më shumë se 28 ditë. Sipas rregullores përkatëse, çdo klub kompensohet me 20 mijë e 548 euro, në ditë humbje të një lojtari ndërkombëtar që është dëmtuar me kombëtaren e tij.

15 futbollistë pritet të largohen nga Manchester Unitedi

Manchester Unitedi nuk po kalon nëpër një formë të mirë as në këtë edicion. Rezultat pozitiv po u mungojnë në shumicën e ndeshjeve, prandaj pritet të ketë ndryshime në radhët e futbollistëve. Mediet angleze raportojnë se trajneri Eric Ten Haag e ka përgatitur listën prej 15 futbollistëve që t’i largojë nga klubi. I pari sigurisht që do ta hapë derën e daljes do të jetë Jadon Sancho, i cili ka prishur marrëdhëniet me trajnerin holandez.

Presidenti i Al-Ittihadit paralajmëron transferimin e Salahut, De Bruyne dhe Ramosit

Arabët dominuan merkaton verore, duke siguruar firma me emra të njohur falë shumave të çmendura që ofronin. Paratë nuk janë problem në ato anë, me sheikët që janë fiksuar pas futbollit. Cristiano Ronaldo ishte ndër të parët që zgjodhi milionat arabe, duke firmosur me Al-Nassr, klub ku përfiton rreth 200 milionë euro. Aktivë ishin edhe te kampionët në fuqi të Al-Ittihad. Drejtuesit ofruan në skuadër emra si Karim Benzema, Ngolo Kante apo Fabinho. Presidenti i Al-Ittihadit tentoi gjatë ditëve të fundit të merkatos dhe goditje si Momo Salah apo Kevin De Bruyne, por nuk ia doli. “Unë qëndrova në heshtje... Por shpresoj të jem në gjendje të shpejti të përgjigjem për atë që ndodhi në javën e fundit të merkatos verore në lidhje me Salah, De Bruyne dhe Sergio Ramos”, u shpreh kreu i klubit saudit. Pjesë e kampionatit arab të futbollit janë bërë edhe emra si Neymar, Sadio Mane, Roberto Firmino dhe Riyad Mahrez.

Usyk paralajmëron Fury: Do të flas në ring

Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk ka qëndruar i qetë në daljet e fundit në publik. Madje kështu bëri edhe disa ditë më parë, kur u takua “ballë për ballë” me Tyson Fury. Në konferencën për shtyp ata paraqitën sfidën që do të

zhvillojnë së bashku më 17 shkurt, kur do t’i unifikojnë titujt kampionë bote në peshën e rëndë. Dueli i shumëpritur mes dy boksierëve të pamposhtur do të zhvillohet në Arabinë Saudite. Tyson Fury e quajti

kundërshtarin ukrainas një “burrë të vogël, të shëmtuar, sallam”, duke dëshmuar se lojërat e mendjes tashmë kanë filluar. Usyk është kundërpërgjigjur duke folur për “Sky Sports”: “Tashmë jam në kokën e tij. Po

këndoj dhe kërcëj atje. Nuk dua të flas shumë sot. Do të flas në ring, më 17shkurt. Më në fund, dueli që kam pritur me aq shumë dëshirë është aty”. Të dy duhej të përballeshin më 23 dhjetor, por sfida u shty dy muaj, pasi Fury kërkoi më

shumë kohë për t’u përgatitur, pas duelit që zhvilloi më 28 tetor ndaj Francis Ngannou. Të dy boksierët kanë nisur përgatitjet për këtë duel të madh, që pritet të jetë një nga ngjarjet më të mëdha sportive të vitit 2024.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Lina-Ks” Sh.p.k, Harilaq, Fushë Kosovë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Implantin për prodhimin e Plehrave Bio Organo – Minerale.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.01.2024 në ora 10:00 në SHFMU “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe,do të organizohet Debat Publik nga Kompania“Lina-Ks” Sh.p.k, Harilaq, Fushë Kosovë,në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Lina-Ks” Sh.p.k, Harilaq, Fushë Kosovë, për Impiantin për prodhimin e Plehrave Bio Organo – Minerale në Harilaq, Fushë Kosovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “LEO ELEKTRO INSTALER” SH.P.K. me seli në Skenderaj, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b UNIK: 812047787 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "LEO ELEKTRO INSTALER" D.O.O. od Skenderaj, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812047787 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “LEO ELEKTRO INSTALER” L.L.C. with headquarters Skenderaj, has come to the decision to quit its business: 812047787 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- - N.T.P. “Blera M” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810930059.

 - Arlind G. Gashi B.I. Frishop Ari shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 812056093.

 - Afrim Sahatqija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

 - Marigona Nue nga Doli, KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Anton Qeta” Dol, KK Gjakovë nga kl. I-X dhe VI-IX.

 - Dea Qerkezi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10. 11. 12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

 - Shaqir Jashari B.I shpall të pavlefshme arkën fiskale me numër UNIK: 811116070.

 - Imer Himaj nga Osek Hyla KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, të sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë Transport Rugorë.

 - Bedri Nezaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klm I, II të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

 - Fisnik Kumnova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë Gjakovë.

 - Ferdane Alidemaj shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greicevci”.

 - Ubejd Gashi shpall te pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës me nr. të diplomës 4157.

 - Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

 - Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

